



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT BE QENDRA

BE LAJME



Tetor 2019
EUC-numër 49/2019

REZOLUTA E PARLAMENTIT EVROPIAN PËR HAPJEN E NEGOCIATAVE ADERUESE ME MAQEDONINË E VERIUT DHE SHQIPËRINË



Parlamenti Evropian në seancën plenare më 24.10.2019 miratoi Rezolutë për hapjen e negociatave aderuese me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, të votuar nga 412 eurodeputetë, 136 votuan "kundër" dhe 30 ishin "të përmbajtur". Propozim-rezoluta ishte parashtruar nga 58 eurodeputetë.

Me Rezolutën, Parlamenti Evropian e shpreh zhgënjimin e thellë për dështimin e Bashkimit Evropian për të dhënë pëlqim për fillimin e negociatave aderuese me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, për shkak të bllokimit nga Franca, Danimarka dhe Holanda, megjithëse të dyja vendet kanë bërë përpjekje të konsiderueshme dhe i kanë përmbushur kërkesat për fillimin e negociatave.

Rezoluta shënon se mosdhënia e dritës jeshile për të filluar negociatat është një gabim strategjik dhe ka një efekt negativ në besueshmërinë e BE-së. Politika e zgjerimit të BE-së është instrumenti më efikas i politikës së jashtme të BE-së. Lënia e këtij instrumenti mund të çojë në rritjen e jostabilitetit të BE-së.

Parlamenti Evropian shpreh keqardhje që vendet anëtare nuk kanë arritur të marrin vendim unanim për të filluar negociatat. U bën thirrje vendeve anëtare të tregojnë përgjegjësi për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë dhe të miratojnë njëzëri vendim pozitiv për hapjen e negociatave në sesionin tjetër dhe t'i marrin parasysh pasojat e mosndërmarrjes së veprimeve në atë drejtim.

Me Rezolutën përshëndetet roli historik i Maqedonisë së Veriut në zgjidhjen e çështjeve të hapura bilaterale dhe për avancimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, veçanërisht përmes Marrëveshjes së Prespës me Greqinë dhe Marrëveshjes për Miqësi, Fqinjësi të mirë dhe Bashkëpunim me Bullgarinë.

Parlamenti Evropian i bën thirrje Këshillit t'i marrë parasysh porositë pozitive të këtyre marrëveshjeve dhe kontra-efektet e vendimit të Këshillit për stabilitetin politik, bashkëpunimin rajonal dhe bashkëjetesën paqësore.

Rezoluta fton në vazhdimin e Dialogut Zhan Mone me Kuvendin e Maqedonisë së Veriut si instrument kryesor për mbështetje.

Rezoluta i përshëndeti konkluzionet e takimit të liderëve në Maqedoninë e Veriut më 20.10.2019, i cili e konfirmoi përkushtimin e vendit për procesin evropian të aderimit dhe theksohet se Maqedonia e Veriut nuk ka alternativë tjetër përveç proceseve eurointegruese.

Vendimi i Këshillit Evropian dërgon një sinjal paralajmërues për vendet-kandidate dhe vendet e mundshme kandidate të Ballkanit Perëndimor dhe krijon mundësi të ndikimit në vendet e tjera, të cilat mund ta ngadalësojnë ose ndalojnë plotësisht zbatimin e reformave proevropiane në vendet kandidate të BE-së.

Rezoluta thekson se të rinjtë në rajon kanë pritshmëri të mëdha në lidhje me aderimin në BE dhe beson se e ardhmja pa një perspektivë të qartë mund të çojë në migrimin nga rajoni.

Rezoluta i bën thirrje PE-së, si përgjigje e ngërçit të Këshillit Evropian, të thërras dialog rajonal parlamentar me udhëheqjen e parlamenteve të Ballkanit Perëndimor, në mënyrë që të hartojë strategji për rolin e parlamenteve në avancimin e agjendës së reformës në BE.

Përmbajtja e lajmeve:

Rezoluta e Parlamentit Evropian për hapjen e negociatave aderuese me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë	1
Këshilli Evropian pa konsensus për zgjerimin	2
Rezoluta (2304) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës	2
Parlamentet e Gjermanisë dhe Holandës me mbështetje për datën për negociatën me BE-në	3
Samiti social vjeshtor	3
Në fokus të Parlamentit Evropian	4
Përbërja e re e Komisionit Evropian e merr detyrën nga 1 dhjetori	5
U arrit marrëveshja për Bregzitin	5
Aktivitetet e Kuvendit lidhur me çështjet evropiane	6-7
Agjenda evropiane e punës filloi me punë	8
Indeksi për barazi gjinore për vitin 2019	8
Buxheti i Bashkimit Evropian 2021-2027	9
Monitori i dytë i qyteteve kreative dhe kulturore evropiane 2019	9
Ferment organik rajonal në Bashkimin Evropian	10
Mësimdhënës në Bashkimin Evropian	10
Në Francë u hap parku më i madh solar lundrues	11
Kalendari i BE-së / nëntor 2019	11

KËSHILLI EVROPIAN PA KONSSENSUS PËR ZGJERIMIN



Liderët evropianë pas bisedimeve të gjata më 18 tetor në Bruksel, nuk arritën të bien dakord për zgjerimin. Në konkluzat e shkurtëra nga samiti dy-ditor të liderëve dhe krerëve të BE-së është theksuar se Këshilli Evropian do të kthehet në çështjen e zgjerimit para samitit të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në maj 2020.

Sipas Euroactiv.com, të gjitha pritjet i drejtoheshin Presidentit Francez Emanuel Makron, qëndrimi i të cilit ishte një pengesë për vendimin për hapjen e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Shtetet anëtare Franca, Gjermania, Holanda dhe Danimarka po konsideronin një kompromis për të zhvendosur bisedimet në prill të vitit të ardhshëm ose në samitin BE-Ballkan Perëndimor në maj të vitit 2020 në Zagreb.

Më herët, Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian rekomanduan hapjen e negociatave të pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, dhe se Maqedonia kishte mbështetjen e të gjitha vendeve anëtare përveç Francës, për shkak të vendimit historik për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me Greqinë dhe ndryshimin e kushtetutës.

Franca nuk është e gatshme të hap derën e BE për anëtarë të ri në një kohë kur problemet me korrupsionin dhe sundimin e së drejtës në anëtarët e ri si Polonia, Hungaria dhe Rumania po dëmtojnë unitetin e BE-së. Franca dëshiron që Komisioni Evropian të reformojë thellësisht mënyrën e trajtimit të negociatave të pranimit në BE. Në samitin Danimarka, Holanda dhe Spanja propozuan ndarje në procesin e Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, me çka kanë kundërshtuar Italia, Gjermania dhe Franca.

"Unë kam bërë gjithçka që mundem për të mbështetur Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, por ne ende kemi disa shtete anëtare që janë skeptik në lidhje me negociatat e pranimit," - deklaroi Kryetari i Këshillit Evropian Donald Tusk.

Komisioneri i BE-së për zgjerim Johanes Han shprehu zhgënjimin që liderët e BE-së dështuan në përmbushjen e premtimit të tyre për hapjen e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, dhe i bëri thirrje BE-së dhe vendeve anëtare të sqarojnë se sa serioz është angazhimi i tyre për integrimin evropian në Ballkanin Perëndimor. Në Twitter, Komisioneri Han shkroi "Mosarritja e pranimit të provuar do të ketë pasoja negative, përfshirë rrezikun e destabilizimit të Ballkanit Perëndimor me ndikim të plotë të BE". "Ne kemi nevojë për një proces të ri të zgjerimit dhe një vendim strategjik se kush jemi dhe ku duam të zgjerohemi. Ne së pari duhet të bëjmë përparim në reformën e BE ... Unë nuk jam dakord që zgjerimi duhet të jetë një ideologji e BE-së," tha Presidenti Francez Makron në një konferencë shtypi pas samitit.

<https://euobserver.com/enlargement>

REZOLUTA (2304) E ASAMBLESË PARLAMENTAREHA TË KËSHILLIT TË EVROPËS



Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, më 2 tetor të këtij viti, në seancën e saj të 32-të, miratoi Rezolutën 2304 mbi dialogun pas monitorimit me Maqedoninë e Veriut, bazuar në raportin e Liz Kristofersen (Norvegjia, SPC) dhe Alexandar Pocij (Poloni, EPP / CD). Asambleja Parlamentare ju dha njohje autoriteteve në shtet

mbi përparimin e bërë që nga viti 2013 dhe vendosi të vazhdojë dialogun pas monitorimit dhe të vlerësojë progresin në pesë fushat e mëposhtme në raportin vijues: konsolidimin e mëtejshëm të funksionimit të institucioneve demokratike, forcimin e pavarësisë së gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit, forcimin e kornizës zgjedhore dhe zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të drejtave të pakicave.

Rezoluta 2304 mirëpret hapat e ndërmarrë pas dy viteve të tranzicionit politik, si dhe përmirësimin e dukshëm të marrëdhënieve me fqinjët e saj. Argumentohet që ligjet e miratuara së fundmi duhet të zbatohen plotësisht në mënyrë që të forcojnë gjyqësorin dhe të konsolidojnë sundimin e të drejtës. Në seancën e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, fjalimet e mëposhtme u drejtuan nga deputetët e Kuvendit: Betian Kitev, Nikolla Poposki, Shpresa Hadri.

<http://www.assembly.coe.int>

PARLAMENTET E GJERMANISË DHE HOLANDËS ME MBËSHTETJE PËR DATË PËR NEGOCIATA ME BE

Bundestagu Gjerman më 27 shtator 2019 mbështeti fillimin e negociatave të pranimit në BE për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Një shumicë dërrmuese e 476 deputetëve votuan për të filluar negociatat e pranimit me Maqedoninë e Veriut, me 122 kundër dhe 16 abstenime. Deputetët gjermanë nuk kanë vendosur kushte për fillimin e bisedimeve të pranimit në BE me Maqedoninë e Veriut. Ligjvënësit nga Partia Demokratike e Krishterëve të qendrës së djathtë në pushtet kanë shprehur mbështetje për përpjekjet për reformën e vendit, duke përmendur marrëveshjen historike për "emrin" në vitin 2018 me Greqinë, si një shembull i arritjeve për të gjithë rajonin që mbylli një mosmarrëveshje me dekada të tëra. Shtetit iu kërkua të vazhdojë kursin e saj të reformave, veçanërisht në fushat e sundimit të ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe krimit dhe të drejtave të njeriut.



<https://www.reuters.com>



<https://balkaninsight.com>

Parlamenti Hollandez më 09 tetor mbështeti Maqedoninë e Veriut në caktimin e një date për fillimin e negociatave të anëtarësimit në BE, por shprehu rezerva për ofertën e Shqipërisë, kryesisht për shkak të përparimit të dobët në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Deputetët Hollandezë shprehen pozicionin e tyre një javë para një mbledhje kryesore të Këshillit Evropian në 17-18 tetor, dhe vendimin e dy vendeve për të filluar negociatat në BE. Në një seancë të Komisionit Parlamentar për Çështje Evropiane, të mbajtur me iniciativën e Ministrit të Punëve të Jashtme Shtef Blok, ishte dhënë pëlqim që Maqedonia e Veriut kishte ndërmarrë shumë hapa pozitiv vitet e fundit.

SAMITI SOCIAL I VJESHTËS

Tema kryesore e Samitit Social të Vjeshtës ishte "Progresi në Dimensionet Sociale dhe Ekonomike të Evropës Konkurruese, të Drejtë dhe të Qëndrueshme: Roli i Partnerëve Socialë dhe Dialogut Social", i mbajtur në Bruksel më 16 tetor të këtij viti. Fokusi i diskutimeve në këtë samit ishte në tre fusha:

- një tranzicion i drejtë në një ekonomi neutrale klimaterike,
- investimi në aftësi dhe përmirësimi i aksesit në trajnimin e të rriturve, dhe
- hartimin e një politike industriale të përshtatshme për të ardhmen.

Samiti social trepalësh është një forum për dialog midis institucioneve të BE-së në nivelin e kryetarit dhe partnerëve social evropian në nivelin më të lartë të qeverisjes. Samiti kryesohet nga Kryetari i Këshillit Evropian Donald Tusk, Kryetari i Komisionit Evropian Zhan-Klod Junker dhe kreu i shtetit ose qeveria e kryesisë së rradhës, Kryeministri i Finlandës Antti Rinne.



<https://eu2019.fi/>

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN


www.europarl.europa.eu

Ilham Tohti nga Ujguri,
i cili lufton për të
drejtat e pakicës
kineze Ujgure, është
fitues i shpërblimit
"Saharov" për vitin
2019 të cilin e ndan
Parlamenti Evropian
për lirinë e mendimit

Ilham Kjuçjuk
njoftues i ri për
Republikën e
Maqedonisë së Veriut
në Parlamentin
Evropian

Seanca plenare 9-10 tetor 2019

Eurodeputetët kërkuar zgjidhje për buxhetin e ardhshëm afatgjatë për investime në BE dhe paralajmëruan për ndërprerje të programeve të financuara nga BE.

Në rezolutën e miratuar me 422 vota eurodeputetët ftuan: në dorëzimin e propozimeve ligjore për përcaktimin e rogut minimale në BE dhe fond për ndarje të huave për skemat nacionale për sigurim në rast të papunësisë. Ndërhyrja e huaj gjatë kohës së zgjedhjeve në BE dhe përpjekjet për të ndikuar në vendimmarrje në BE tentimet të ndikohet ndaj marrjes së vendimeve në BE i vendos në rrezik shoqëritë demokratike evropiane, paralajmëruan eurodeputetët në rezolutë me 469 vota.

Eurodeputetët kundërshtuan planet e Komisionit të miratoj import të OMGJ-ve prodhime tolerante të herbicideve me bazë glifosat dhe amonium glufosinat, në rezolutë jo detyruese të miratuar në seancën plenare.

Në rezolutë të miratuar me 426 vota, eurodeputetët vunë në dukje rrezikun që plani i investimit në BE-së 2021-2027 nuk do të bihet dakord me kohën me Këshillin dhe kërkoj për konfirmim qëndrimi i përbërjes paraprake të PE për Kornizën financiare shumëvjeçare të ardhshme, të miratuar në nëntor të vitit 2018.

Sesioni plenar 21-24 tetor 2019

Parlamenti Evropian miratoi masë për të siguruar që fondet e BE-së për vitin 2020 janë plotësisht në dispozicion nëse Britania e Madhe largohet nga BE pa marrëveshje. Propozim rregullativ shtrihet deri më vitin 2020 për gjendje të jashtëzakonshme të miratuar nga Parlamenti Evropian më 17 prill këtë vit. Hulumtuesit, studentët dhe bujqit nga Britania e Madhe duhet të vazhdojnë të marrin mbështetjen e BE-së në rast se nuk arrihet marrëveshje.

Eurodeputetët miratuan ndryshim në Fondin e Solidaritetit të Fondit Evropian për përshtatjen e Globalizimit për të përfshirë mbështetjen për punëtorët që do të preken nga tërheqja e Britanisë së Madhe nga BE pa marrëveshje.

Eurodeputetët u informuan për procedurën e zgjedhjeve të Ombudsmanit

të ardhshëm të BE-së. Thirrja për nominim u botua në Gazetën Zyrtare të BE-së më 30 gusht 2019. Kandidatët do të ftohen të paraqesin prioritetet në diskutim të cilin Komisioni i Peticioneve do ta mbajë më 3 dhjetor 2019. Avokati i Popullit do të zgjidhet me votim të fshehtë në seancën plenare të dhjetorit të PE.

Parlamenti Evropian në projekt rezolutë theksoi se buxheti i BE-së për vitin 2020 është "shansi i fundit që Bashkimi të afrohet në përmbushjen e angazhimeve politike të përcaktuara për atë periudhë, përfshirë edhe arritjen e qëllimeve të BE - së për klimën".

Ilham Tohti nga Ujgur, i cili lufton për të drejtat e pakicës kineze Ujgure, është fitues i shpërblimit "Saharov" për vitin 2019 të cilin e ndan Parlamenti Evropian për lirinë e mendimit.

Tohti është luftëtar për dialog dhe përfaqësues për zbatimin e ligjeve rajonale të autonomisë në Kinë. Që nga viti 2014 Tohti është dënuar me burg të përjetshëm për separatizëm.

Shpërblimi do të ndahet më 18 dhjetor në ceremoni solemne në PE në Strasburg. Eurodeputetët miratuan rezolutë në të cilën i ftojnë vendet anëtare të punojnë në rregulla afatgjata me të cilat detyrohen që kompanitë multinationale të zbulojnë se çfarë tatimesh paguajnë në secilin vend.

Eurodeputetët diskutuan për konkluzionet e samitit të BE-së në 17-18 tetor në seancën plenare me kryetarët Juncker dhe Tusk. Kryetari Tusk e quajti "gabim" vendimin për të mos filluar negociatat për aderim me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë.

Për temën e zgjerimit me Ballkanin Perëndimor, pothuajse të gjithë folësit e kanë dënuar dështimin për të arritur unanimitet në Këshillin Evropian përkundër mbështetjes së gjerë në të gjithë BE-në.

PËRBËRJA E RE E KOMISIONIT EVROPIAN FILLON DETYRËN NGA 1 DHJETORI

Parlamenti Evropian planifikon përbërjen e re të Komisionit Evropian, të udhëhequr nga Ursula Fon der Lejen, të marrë funksionin nga 01 dhjetori, një muaj më vonë se sa pritej, pasi Hungaria, Rumania dhe Franca duhej të nominonin kandidatë të rinj për Komisionarë Evropian.

Presidenti i PE David Sasoli më 12 tetor theksoi se zgjedhja e Komisionit të ri ka të ngjarë të prolongohet për një muaj. Komisioni Evropian duhej të qasej në detyrë në 1 nëntor të këtij viti, por PE kundërshtoi tre kandidatë për komisionar, duke vonuar procesin. Gjatë vlerësimit të cilësisë së kandidatëve, nominimet e Hungarezit Laslo Troçani (për resorin Zgjerim të BE) dhe rumunnja Rovana Plumb (resori i transportit) u refuzuan për "konflikt interesi", ndërsa francezja Silvi Gular (resori tregu i vetëm) nuk kaloi në dëgjim nga eurodeputetët për "arsye etike".

Votimi i PE për të gjithë ekipin e Komisionit Evropian të ri duhej të mbahej në 23 tetor të këtij viti. Por Komisionin e ri Parlamenti Evropian mund të



prononcohet gjatë seancave plenare në 13-14 nëntor në Bruksel ose 25-28 Nëntor në Strasburg.

<https://www.reuters.com>

MARRËVESHJA E ARRITUR PËR BREGZIT

Bashkimi Evropian dhe Britania e Madhe arritën marrëveshje për Bregzit në 17 tetor të këtij viti, e cila nëse ratifikohet qytetarët dhe kompanitë do të ketë më në fund një pamje të qartë se çfarë të presin në të ardhmen.

Marrëveshjen e mëparshme, të cilën në dhjetor 2018 e arriti ish-kryeministria Tereza Mej, u refuzua tre herë nga Parlamenti Britanik.

Çështja e kufirit me Irlandën dhe si të ruhet fluksi i lirë i njerëzve dhe mallrave përtej kufirit të vetëm tokësor të Britanisë së Madhe dhe disa prej vendeve anëtare të BE-së ka qenë rekomandim kryesor në rolet për Bregzit që nga fillimi. Kufiri i hapur është thelbësor për ekonominë rajonale dhe procesin paqësor në Irlandën Veriore.

Fillimisht, kryeministri britanik Boris Xhonson insistoi në të gjithë Britaninë dhe Irlandën Veriore të linin bashkimin doganor, i cili do të çonte në rekomandime të pashmangshme të kufirit. Sipas marrëveshjes së re, problemi zgjidhet duke e mbajtur Irlandën Veriore në tregun e vetëm dhe duke hequr kontrollin doganor në anën irlandeze të kufirit, duke mbajtur kështu kufirin të hapur. Kontrollin doganor dhe doganat do të kenë të bëjnë me mallrat britanike që hyjnë në Irlandën Veriore me destinacionin përfundimtar të BE-së. BE, nga ana tjetër, ka pranuar të bëjë kompromis dhe i ka lejuar Irlandës Veriore qasje të veçantë në tregun e vetëm - diçka që nuk u pranua në marrëveshjen e mëparshme për Bregzit.

Sipas marrëveshjes së re, Mbretëria e Bashkuar do të largohet nga BE në 31 tetor të këtij viti, por mbetet në tregun e vetëm evropian deri në fund të vitit 2020, derisa të dy palët të negociojnë marrëdhënie të reja tregtare. Mbretëria e Bashkuar deri në fund të vitit 2020 do të duhet të paguajnë kontribute pensioni për administratën e punësuar në BE dhe programet e BE që përfshin Britaninë, me vlerë rreth 39 miliardë funta. Qytetarët evropianë që aktualisht jetojnë dhe punojnë në Britaninë e Madhe dhe britanikët që punojnë në BE nuk do të humbasin të drejtat e tyre civile për vendbanim



dhe punë. Sidoqoftë, qytetarët evropianë nuk do të jenë më në gjendje të shkojnë lirshëm për të punuar në Britani dhe anasjelltas, dhe udhëtimi pa viza do të mbahet për vizita të shkurtra.

Kryetari i opozitës Britanike i Partisë Laburistike Xheremi Korbin u bëri thirrje deputetëve që të refuzojnë marrëveshjen e re për Bregzit. Sipas Korbin "mënyra më e mirë për të zgjidhur Brexitin është t'i jepni popullit fjalën e fundit në votim".

Parlamenti Britanik më 19 tetor refuzoi të votojë marrëveshjen e re të Bregzit, duke kërkuar prolongim për herë të tretë.

Parlamenti Britanik më 28 tetor hodhi poshtë propozimin e kryeministrit Xhonson më 12 dhjetor për të mbajtur zgjedhje të parakohshme. Bashkimi Evropian ka pranuar prolongim të Bregzitetit deri më 31 Janar.

<https://www.bbc.com>

AKTIVITETET PARLAMENTARE TË LIDHURA ME ÇËSHTJE EVROPIANE



www.sobranie.mk



Kryetari i Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut merr pjesë në Konferencën e Kryetarëve të Paramenteve të Këshillit të Evropës më 24 tetor në Strasburg, Xhaferi i drejtohet Konferencës Evropiane të Kryetarëve të Paramenteve me temën "Shtëpia jonë e përbashkët evropiane: 70 vitet e ardhshme" në të cilën ai theksoi se nuk ka asnjë alternative, por anëtarësim i plotë në BE dhe NATO, një vazhdim edhe më i rregullt i reformave, në të mirë të qytetarëve tanë, për përparimin dhe zhvillimin e vendit tonë. Në Parlamentin Evropian në Strasburg, Xhaferi u takua edhe me kryetarin e Parlamentit Evropian David Sasoli dhe Zëvendës kryetaren Klara Dobrev. Në takim, Kryetari Xhaferi shprehu mirënjohje Parlamentit Evropian për mbështetjen e vazhdueshme të procesit të zgjerimit të BE-së dhe mbështetjen e eurodeputetëve për Maqedoninë e Veriut për të filluar pa kushte negociatat e anëtarësimit në BE. Kryetari i Parlamentit Talat Xhaferi gjithashtu u takua me eurodeputetët: Dejvid Mekalister, Kryetar i Komitetit për Punë të Jashtme të PE, Andreas Shider, Bashkë-Kryesues i KPP të BE dhe Republika e Maqedonisë së Veriut, Ilham Kjuçjuki, Raportues për Republikën e Maqedonisë së Veriut në PE, si dhe njoftues në fshehtësi Tanja Fajon. Eurodeputetët riafirmuan mbështetjen e fuqishme të Parlamentit, dhe bashkëpunimi në formën e Komitetit të Përbashkët Parlamentar dhe Dialogu Zhan Mone do të vazhdojë rregullisht.

Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, më 10 tetor 2019 pati takim me Kryetarin e Qeverisë së Republikës së Sllovenisë, Marjan Sharec. Në takim, Xhaferi informoi se Republika e Maqedonisë së Veriut e tejkaloi me sukses çështjet e hapura me Republikën e Greqisë dhe Republikën e Bullgarisë në një periudhë relativisht të shkurtër kohore dhe hapi rrugën për anëtarësimin në NATO.



Delegacioni i Kuvendit nga 13 deri në 17 tetor 2019 në Beograd, Republika e Serbisë mori pjesë në 141 Asamble të Unionit Ndër-Parlamentare (IPU) në përbërje: Talat Xhaferi, Kryetar i Kuvendit dhe Shef i Delegacionit, Dime Velkovski, Dimitar Stevanxhija, Agim Shaqiri dhe Juliana Nikolova, anëtarë të Delegacionit dhe Cvetanka Ivanova sekretar shtetëror i Kuvendit. Kryetari Xhaferi bëri deklaratë duke theksuar angazhimin për të siguruar kornizë ligjore mbi të cilën do të bazohen tre fushat më të rëndësishme të pavarësisë legislative, pavarësisë financiare, shërbimit të pavarur dhe sigurisë së pavarur. Kryetari i Parlamentit Xhaferi u takua me: Ali Ardeshir Larixhani Kryetar i Parlamentit të Republikës Islamike të Iranit, Kryetari i Fjalës së Shtetit të Republikës së Sllovenisë Dejan Zhdan, Delegacionet e Meksikës të kryesuar nga

Laura Angelika Rohas Erhandez kryetar i shtëpisë përfaqësuese delegacioni nga Bosnja dhe Hercegovina e udhëhequr nga Nebojsa Radmanović Nënkrjetari i Shtëpisë përfaqësuese, Nikola Shpiriq Nënkrjetari i Shtëpisë së Popujve të Asamblesë Parlamentare të BiH, Delegacioni Australian Duke udhëhequr nga Lusi Viks deputet në Shtëpinën e Përfaqësuesve të Parlamentit Australian dhe Kryetari i Asamblesë Kombëtare të Republikës së Serbisë Maja Gojković. Në takime, Xhaferi informoi bashkëbiseduesit për situatën aktuale në lidhje me integrimin euro-atlantik të Maqedonisë së Veriut, përkatësisht pritjet për marrjen e date për fillimin e negociatave të pranimit me Bashkimin Evropian dhe integrimin në NATO.

AKTIVITETET PARLAMENTARE TË LIDHURA ME ÇËSHTJET EVROPIANE

Këshilli Nacional për Integritet Evropian në Sesionin e gjashtë të mbajtur në 14 Tetor 2019 diskutoi pritjet dhe perspektivat në procesin e pranimit në BE. Në takim morën pjesë Zëvendëskryeministri përgjegjës për Çështjet Evropiane, z. Bujar Osmani, anëtarët e Komisionit për Çështjet Evropiane, Komisioni i Politikës së Jashtme, Komiteti i përzier Parlamentar RM-BE, organizatat e shoqërisë civile, institucionet, si dhe ambasadorët e shteteve anëtare të BE-së në vend. Në vijim ishin të pranishëm në debat: Znj. Shpresa Hadri, Anëtare e Këshillit; Znj. Bojan Mariçiq nga Kabineti i Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Znj. Jagoda Shahpaska, Anëtare e Komisionit për Çështjet Evropiane, dhe Znj. Lidija Dimova, Drejtore e Agjencisë Nacionale të Programeve të Edukimit Evropian dhe mobilitetit.



Komisioni Monitorues i APKE do të zhvillojë seancë pasditen e 2 tetorit 2019. miratoi në Strasburg Rezolutë mbi Dialogun e Pas-Monitorimit me Republikën e Maqedonisë së Veriut, bazuar në raport të përgatitur nga Lisa Kristofersen, deputete e Parlamentit nga Norvegjia dhe Alexander Pocij, deputet nga Polonia. Në tekst, Komisioni pranon autoritetet e Maqedonisë së Veriut për përpërimin e bërë në vitin 2013. deputetët Betijan Kitev, shefi i Delegacionit, Nikola Poposki dhe Shpresa Hadri iu drejtuan seancës. Në ditën e parë të seancës, Sekretari Francez i Shtetit për Çështjet Evropiane Amelie de Monshalan përshëndeti guximin e madh politik të Qeverisë për të arritur Marrëveshjen e Prespës.

Me ftesë të Bertrand Sor, kryetari i Grupit të Miqësisë Francë- Maqedonia e Veriut në Asamblenë Nacionale të Republikës Franceze, Delegacioni i Grupit Parlamentar të Asamblesë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për bashkëpunim me Parlamentin e Republikës Franceze: Pance Ivanov, kryetar, Betian Kitev, Lidija Tasevska, Nikola Poposki, Vesna Damcevaska-Ilievska, Daniela Rangelova dhe Fadil Zendeli, anëtare të grupit nga 8 tetor deri më 10 tetor 2019 kanë bërë vizitë pune në Asamblenë Nacionale dhe Senatin e Republikës së Francës. Në takimet e zhvilluara gjatë vizitës, deputetët theksuan se në interes të forcimit të stabilitetit rajonal, Republika e Maqedonisë së Veriut i kush-ton vëmendje të madhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, të cilat saktësohen nga takimet e nivelit më të lartë me Shqipërinë, Kosovën, Republikën e Serbisë, Bullgarinë dhe marrëdhëniet pozitive bilaterale me Greqinë. pasi u nënshkrua Marrëveshja e Prespës.



Me rastin e 15 tetorit - Ditës Ndërkombëtare të Shkopit të Bardhë - simbolin e burrit të verbër, përfaqësuesit e Shoqatës së të Verbërve dhe shikim të dëmtuar nga Shkupi vizituan Kuvendin. Si pjesë e vizitës, u mbajt takim me dy deputetë të parlamentit, nënkryetarë të Grupit parlamentar ndër-partiak për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Kuvendi vazhdimisht ndërmerr aktivitete për të promovuar kulturë të hapjes së legjislaturës duke përfshirë dhe informuar të gjitha kategoritë e qytetarëve dhe shoqatave, si dhe duke shqyrtuar mundësitë për bashkëpunim të ardhshëm.

AGJENCIA EVROPIANE E PUNËS FILLOI ME PUNË



Agjencia evropiane e punës zyrtarisht filloi me punë me ceremoninë përuruese dhe mbledhjen e parë të Bordit Drejtues të përbërë nga përfaqësues të vendeve anëtare, Komisioni Evropian, partnerët socialë në nivel të BE-së, Parlamenti Evropian, dhe mbikëqyrësit nga Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Zvicra dhe agjencitë tjera të BE-së, në sferën e punësimit dhe punëve sociale.

BE-ja ka legjislacion të rëndësishëm i cili rregullon aspekte të ndryshme të mobilitetit, të cilin Komisioni i Junkerit e revidoi dhe e përmirësoi në vitet e kaluara. Që ta lehtësohet zbatimi i rregullave, Komisioni propozoi formim të organit të ri si mënyrë e përforsimit të bashkëpunimit të strukturuar dhe këmbimit ndërmjet organeve nacionale kompetente.

Qëllimet e Agjencisë Evropiane për Punë janë:

- lehtësimi i qasjes në informata dhe shërbime të qytetarëve dhe sektorin e biznesit për të drejtat dhe obligimet e tyre,
- lehtësimi i bashkëpunimit ndërmjet vendeve anëtare në zbatimin e legjislacionit të BE-së në kuadër të fushëveprimit të vet dhe me lehtësimin e inspektimeve të harmonizuara dhe të përbashkëta, dhe ballafaqim me punën e paparaqitur, dhe
- ndërmjetësimi dhe lehtësimi i zgjidhjeve në raste të kontesteve tejkufitare.

Aktivitetet e agjencisë kanë të bëjnë me rregullat për mobilitet të punës përkatësisht të lëvizjes së lirë dhe dërgimit të punëtorëve, koordinimit për sigurim social dhe legjislacion specifik në sektorin për komunikacion rrugor. Nuk do të krijohen kompetenca të reja në nivel të BE-së dhe vendet anëtare do të mbeten tërësisht përgjegjëse për zbatimin e rregullave për punë dhe sigurim social. Vlera e shtuar e agjencisë del nga fakti se kjo do ta lehtësojë bashkëpunimin ndërmjet vendeve anëtare, do t'i orientojë strukturat ekzistuese dhe do të sigurojë mbështetje operative, duke siguruar zbatim më efikas të rregullave.

Më 13 qershor 2019 vendet anëtare u morën vesh që selia e agjencisë së re të jetë në Bratislavë, Republika e Sllovakisë.

<https://europa.eu>

INDEKSI PËR BARAZI GJINORE PËR VITIN 2019



Indeksi më i ri për barazi gjinore nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore tregon se vlerësimi i BE-së për barazi gjinore është zhvendosur vetëm një pikë përqindje 67,4, nga viti 2017. Suedia mbetet në kulmin e tabelës në BE, me 83,6 pika, pastaj vijon Danimarka me 77,5.

Greqia dhe Hungaria kanë më pak se 52 pika. Portugalia është me rritje prej 3.9 pika, e pas tyre është Estonia me 3,1 pika.

Bilanci i jetës së punës dhe lidhshmëria e tij me barazinë gjinore është fokus i veçantë i indeksit vjetor. Mungesa prindërore është një prej masave të rëndësishme të politikës për mbështetje të prindërve, por nuk është e disponueshme për të gjithë. Në BE, 28% e femrave dhe 20% e meshkujve nuk kanë të drejtë të mungesës

prindërore. Qasja në shërbime të pranueshme dhe cilësore për kujdes për fëmijë është e rëndësishme për balancën ndërmjet punës dhe jetës.

Shkallët e plakjes dhe invaliditetit në BE rriten, që e nxit kërkesën për shërbime për kujdes afatgjatë për pleqtë dhe personat me nevojë të veçanta.

Pensionimi para kohe është pjesë e kujdesit afatgjatë joformal në BE. Dallimi është i dukshëm te grupi i moshuar prej 50-64 vjet: 21% e femrave dhe 11% e meshkujve kujdesen për pleq dhe/ose persona me nevojë të veçanta së paku disa ditë në javë.

Indeksi për barazi gjinore është vegël për matje të progresit të barazisë gjinore në BE, i zhvilluar nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE).

Indeksi ka gjashtë domene themelore - punë, para, njohuri, kohë, fuqi dhe shëndet dhe dy domene plotësues: dhuna mbi femrat dhe kryqëzimi i pabarazisë. Ai u jep dukshmëri më të madhe sferave të cilëve u nevojitet përmirësim dhe jep mbështetje kreatorëve të politikave të dizajnojnë masa më efektive për barazi gjinore.

Për herë të parë, indeksi e thekson gjendjen e LGBT-së dhe femrave Rome dhe myslimane në sferat me statistikë të disponueshme.

<https://eige.europa.eu>

BUXHETI I BASHKIMIT EVROPIAN 2021-2027

Para mbledhjes së Këshillit Evropian më 17 dhe 18 tetor, Komisioni Evropian i thirri shefat e shteteve dhe qeverive të BE-së, për të siguruar udhëheqje politike dhe nxitje të re për negociata me qëllim të arritjes së marrëveshjes për BE buxhet të drejtë, të balancuar, më fleksibil afatgjatë të BE-së për periudhën 2021-2027, para fundit të këtij viti.

Korniza e ardhshme financiare shumëvjeçare duhet t'u përgjigjet sfidave të sotme që të mundësojë BE-ja t'i përmbushë pritjet e qytetarëve.

Në komunikatën e publikuar Komisioni Evropian i thekson pikat kryesore që duhet të merren parasysh dhe të jepen drejtime të qarta nga liderët e BE-së me qëllim të arritjes së marrëveshjes së shpejtë, që përfshin:

- niveli i plotë i financimit t'u përgjigjet prioritetëve të përbashkëta të BE-së;
- buxhet më fleksibil me balancë të rregullt ndërmjet politikave dhe fokus të fortë në vlerën e shtuar të BE-së;
- qasja më transparente për financimin e buxhetit të BE-së dhe futja e burimeve të reja të të ardhurave për mbështetje të prioritetëve dhe zvogëlim të barrës për kontributet nacionale dhe
- koherenca e madhe politike, përmes lidhjes më të afërt ndërmjet financimit dhe prioritetëve të politikave dhe përmes veglave më të fuqishme për mbrojtje të



buxhetit të BE-së nga mungesa e sundimit të së drejtës.

Vendimet strategjike për këto elemente duhet të ndihmojnë në avancimin e negociatave rrjedhëse për buxhetin afatgjatë vijues të BE-së, që u morën vesh nga liderët e BE-së në qershor të këtij viti.

Në maj dhe qershor 2018, Komisioni dha propozim për buxhet të ri dhe modern më fleksibil afatgjatë, i orientuar fortë në prioritetet e BE-së, përfshirë edhe propozimet legislative për 37 programe sektoriale. U arrit progres në kornizën e plotë edhe të shumë propozimeve sektoriale.

Sugjerohet nevoja për ballafaqim strategjik dhe udhëheqje nga ana e liderëve me qëllim fillimin në kohë të programeve të reja më 1 janar 2021.

<https://europa.eu>

MONITOR I DYTË I QYTETEVE EVROPIANE KULTURORE DHE KREATIVE 2019

Komisioni Evropian më 8 tetor të këtij viti botoi edicionin e dytë "Monitori për qytete kulturore dhe kreative" – vegël e dizajnuar për caktimin dhe përforsimin e potencialit kreativ dhe kulturor të qyteteve evropiane, me rëndësi të madhe për futjen e rritjes ekonomike dhe kohezionit social. Pas suksesit të edicionit të parë në vitin 2017, edicioni për vitin 2019 paraqet portret të azhurnuar të pasurisë kulturore dhe kreative të Evropës, në ekzemplar të gjerë nga 190 qytete në 30 vende, përfshirë dhe Norvegjinë dhe Zvicrën. Vegla e krijuar nga Qendra e Përbashkët për Hulumtim, Shkencë dhe Njohuri të Komisionit Evropian, e cila e ndjek veglën e ripërpunuar online që mundëson qytetet të shtojnë të dhëna të tyre për mbulim më të detajuar.

Edicioni i parë i "Monitori për qytetet kulturore dhe kreative" i inspiroi organet lokale nëpër gjithë Evropën, p.sh. Madrid (Spanjë) shfrytëzoi dëshmi të përfshira në Monitorin që të kuptojë ndaj cilave mjete kulturore dhe kreative, siç janë monumente, muze, kinë, teatër dhe galeri, kryeqyteti spanjoll, duhet ta orientojë strategjinë e vet për brendimin me qëllim për ta përmirësuar rangun e vet ndërkombëtar. Si rezultat i kësaj, Madridi botoi broshurë të re "Madrid – fakte dhe numra 2018"

Monitori ishte i dobishëm edhe për Hungarinë, në analizën e nevojave të ardhshme investuese dhe sigurimin e dëshmive që e mbështetën vendimin e qytetit në miratimin e Strategjisë për ekonominë kulturore dhe kreative 2019-2028. Në strategjinë u identifikuan masa kryesore që duhet të zbatohen, siç janë




krijimi i hapësirave kreative për artistët dhe dizajn gendra për inkubacion.

Qyteti Umes (Suedi) e shfrytëzoi veglën për ngritje të vetëdijes të palët e prekura lokale, për rolin e investimeve kulturore në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

<https://europa.eu>

FERMA RAJONALE ORGANIKE NË UNIONIT EVROPIAN



Vëllimi i bujqësisë organike dukshëm lëviz në rajonet e UE-së. Sipërfaqja e përgjithshme organike paraqet shumë e "rajonit i cili është me konversion" plus "rajonit i certifikuar". Para se të mund të certifikohet një sferë si "organike", ajo doemos duhet të pësojë proces të konversionit, i cili mund të zgjasë 2-3 vjet në varësi nga kultura bujqësore.

Llojllojshmëria rajonale në UE është prezantua5r në metodat të prodhimit të bujqësore, si për shembull vëllimi i përpunimit organik të tokës. Ekziston vetëm një regjion ku mbi një e gjysmë e sipërfaqes bujqësore përpunohet me metoda organike i prodhimit të derisa 13% të regjioneve ka më pakë se 1% të


sipërfaqes së tyre nën bujqësi organike në vitin 2016.

Pjesë më të madhe në bujqësinë organike ka në regjionin e Salzburgit (Austri), ku rreth 1/2 (52%) të sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzuar bujqësore është shfrytëzuar për bujqësi organike në vitin 2016 (viti i fundit për të cilën janë të kapshme të dhëna regjionale). Ka edhe 7 rajone ku bujqësia organike ka marrë pjesë dhe është zmadhuar nga 1/4 deri në sipërfaqes e përgjithshme të shfrytëzuar bujqësore. Veriperëndim në Çeki (30%), Melersta Norrland në Suedi me (29%), Kalabri në Itali (29%), Burgenland në Austri (27%), Sicili në Itali (26%) dhe Moravskoslezsko në Çeki (25%).

Krahasuar me vitin 2013, zmadhimi i pjesëmarrjes në bujqësinë organike është shënuar në Kalabri në Itali dhe Sallzburg në Austri (11%), ngushtë i përcjell Sicilinë dhe Italinë dhe Regjionin de Bruksel-Kapitale në Belgjikë (me 9%), si dhe Orland në Finlandë (8%).

<https://ec.europa.eu/eurostat>

MËSUESIT NË UNIONIN EVROPIAN



Të dhënat të Unionit Evropian tregojnë se në vitin 2019, në Union 5,8 milionë njerëz kanë punuar si mësues në arsimin fillor dhe të mesëm. Pothuajse 72% nga to ose 4,2 milionë janë gra mësuese.

ndërmjet mësuesve të cilit punojnë në UE, gjysmë milioni ose 9% nga numri i përgjithshëm janë më të rinj se 30 vjet, ndërsa 2,1 milionë ose 36% janë më të moshuar se 50 vjet.

Më shumë se 85% nga mësuesit të cilit punojnë në Lituani dhe letoni janë gra.

Në të gjitha vendet-anëtare të UE-së, mësuesit në vitin 2017 zakonisht janë gra. Pjesa e gra në këtë profesion është më e madhe në Letoni (87%) dhe Lituani (85%), pas çka vijnë Bullgaria, Estonia dhe Sllovenia me nga 85%. Për dallim nga to, pjesa e burrave bë profesionin mësues është më e madhe në Danimarkë (35%, të dhëna për vitin 2014, me përjashtim të arsimit të mesëm) dhe Luksemburg (35%), para Spanjës dhe Greqisë (34%), Francës (32%) dhe Holandës (31%).

Statistika evropiane, gjithashtu tregoi se 9% të mësuesve në UE kanë pasur më shumë se 60 vjet, ndërsa pjesë më të madhe në këtë grup moshe kanë: Estonia (19%), Italia (17%) dhe Gjermania (16%).

<https://ec.europa.eu/eurostat>

NË FRANCË ËSHTË HAPUR PARKU MË I MADH LUNDRUES SOLAR

Lugina e Rona në Francën Jugore është më e njohur pas verave të shkëlqyeshme dhe ushqimit të shkëlqyeshëm, por mund ta shtojë edhe energjinë solare në listën e sajë të njohurisë. Në këtë rajon më 18 tetor 2019, solemnisht ishte lëshuar në përdorim stacioni më i fortë fotovoltai i energjisë (PV), e njohur si Parku solar, që paraqet edhe një kthesë në zhvillimin e energjisë solare.

Projekti OMEGA1 është park solar prej 17 megavat (MW) i vendosur në Piolens, komunë në seksionin Voukle, në afërsi të Orinxh dhe Avinjon. Parku i vetëm dhe më i madh në Evropë i bazuar në teknologji lundruese solare. Kjo strukturë lundruese ndihmon në zvogëlimin e konflikteve rreth përdorimit të tokës prandaj nuk mund të instalohet në rezervuarë për ujë për pije, basena industrial, rrafshina të cilat janë nën ujë ose liqene.

Inovacioni i projektit buron

Për herë të parë, Akuo Enerxhi e hapi qytetin kryesor dhe projekti OMEGA1 për banorët të cilët kanë shtëpi në Voukle dhe rajonin. Qëllimi i kësaj qasje është t'i inkurajojë qytetet të përfshihen në financimin e tranzicionit energjetik duke shfrytëzuar palë të prekura në rajon.

Aspekti inovativ i projektit nuk ndalet këtu. Akuo Enerxhi u bashkua me furnizuesin të pavarur të energjisë elektrike, Pllam Enerxhi me qëllim të zhvillojë etiketë "Energji të gjelbër elektrike me prejardhje të kontrolluar", e cila do të jetë e para e llojit të tillë në Francë. "Kjo ofertë u garanton klientëve të sajë të ardhëm 100% energji të ripërtërishme e prodhuar veçanërisht në Francë, me çka krijohet vlerë në këtë vend", theksojnë nga Akuo prodhues i pavarur kryesor i energjisë nga burime të ripërtërishme në Francë.

Punët të projektit OMEGA1 filluan në vitin 2014, në vendin e një gurëthyes të vjetër, i cili qenka i shndërruar në liqen. Fabrika oficalisht është e inauguruar në prani të ministres franceze për tranzicion ekologjik dhe inkluziv Elizabet Born dhe sekretarësht shtetërore në ministri, Brun Puarson. Sipas promovuesve, prodhimitaria vjetore e fabrikës do të jetë e mjaftueshme për furnizimin e 4.733 shtëpi, duke shmangur lëshim të 1.096 tonë CO₂ në atmosferë.



<http://www.akuoenergy.com/en>

Në Kuvend në muajin tetor u miratua 1 ligj nga NPAA-ja - Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekonomi të ujërave.



BE KALENDAR / nëntor 2019

1. Konferenca për ardhmërinë e LIFE programit të UE-së, 6-7/11/2019, Bruksel, Belgjik;
2. Samit për vende të shëndosha të punës 2019, 12-13/11/2019, Bilbao, Spanjë;
3. Konferenca ndërkombëtare UE DataViz 2019, Qendra për konventa, Luksemburg.
4. Sesion plenar i Parlamentit Evropian, 13-14 dhe 25-28/11/2019, Strazbur;
5. Konferenca e rajoneve të mençura, transformimi nëpërmjet specializimi të mençur, 14-15/11/2019, Bruksel, Belgjik;
6. Dita evropiane e ndërmarrjeve për ekonomi sociale 2019, 14-15/11/2019, Bruksel, Belgjikë.

European Union Newsroom

europa.eu

EUROPA > Newsroom > Calendar

Home Highlights Press releases Calendar Audiovisual Press contacts Press facilities Subscription services About the EU

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic
Choose a topic

By organiser
Choose an organiser

By type
Choose a type

BY MONTH

November

Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat	Sun
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	

Linqe të dobishme për publikimet elektronike të BE-së
<https://publications.europa.eu/en/home>
<https://europa.eu/european-union/documents-publications>
<http://www.europarl.europa.eu/visiting/en/brussels/parlamentarium>



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 Tetori nr. 10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 55 lokal 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

www.sobranie.mk

Në Kuvend ishte zbatuar Projekti IPA Projekt për "Ndhimë Teknike për Parlamentin" në periudhën nga janari 2011 - qershor 2012, qëllimi i të cilit ishte përforcimi i kapaciteteve institucionale të Kuvendit dhe në këtë mënyrë përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësisë ndaj qytetarëve.

Në korniza të projektit IPA, ishte siguruar ndihma financiare dhe ndihma profesionale në vendosjen e qendrës së BE-së në Kuvend.

Qëllimi i formimit të Qendrës së BE-së është deputetëve të Kuvendit dhe Shërbimit tu sigurojë qasje më të mirë në informata lidhur me çështjet e BE-së.

Qendra e BE-së është e organizuar në kuadër të Sektorit për Mbështetjen e Këshillit Nacional të Euro Integritimeve.

Qendra e BE-së disponon me bibliotekë të librave dhe publikimeve nga fusha të ndryshme

